

BIBLIOTEKA

78

094



INSTITUTI I FOLKLORIT

250
Këngë Popullore
Dasme

TIRANË, 1966



78
097

INSTITUTI I FOLKLORIT

250
Këngë Popullore
Dasma

BIBLIOTHEKË E QITETIT
DJIJKASIT

38084

42681

Tiranë 1966

REDAKSIA:

**EFTIM DHERI
MEXHIT DAIU
ARSEN MUSTAQI**

**Vënë në notë: M. DAIU
Redaktimi muzikor: E. DHERI
Redaktimi i teksteve: A. MUSTAQI
Tekniku i inçizimit: MEHMET SHKAMBI**

Kopertina: HYSEN DEVOLLI

Tirashi: 1500

Formati 78x109/16

Stash: 2204-65

Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronja «MIHAL DURI» Tiranë

PARATHENIE

Martesa është një kusht i domosdoshëm për jetën e njeriut, mbasi me anën e saj ai shton vazhdimësinë e jetës. Me anën e asaj themelohet familja, e cila është e vetmja bazë e shoqërisë njerëzore. Për këtë arsye vetë njeriut dhe shoqërisë, duke e vështruar atë si një institucion me rëndësi tepër të madhe, i ka tërhequr vëmëndjen.

Nëpër shekuj edhe populli ynë marrëdhëniet martesore i ka sanksionuar si në të drejtën zakonore ashtu edhe ligjore.

Procesi i martesës kryhet zakonisht në dy etapa: fejesa dhe martesa, të cilat mund të jenë afër, ose pak a shumë edhe larg njera tjetrës, kohë, që dikur, mund të fillonte nga lindja deri në moshën e domosdoshme për martesë.

Këtë vëllim, në të cilin përmbledhen 250 tekste dhe melodi popullore ne e kemi quajtur «250 këngë popullore dasme», mbasi procesi i martesës të të fejuarve kryhet brënda një kohe të caktuar, që siç dihet quhet «dasëm» ose «darsëm».

Dasma, pra, si një ngjarje e madhe për njeriun, si një shprehje e madhe gëzimi, si një ngjarje familjare, me zakonet dhe këngët e veta hyn në ritualet liturike. Po, duke qenë e një rëndësie të dorës së parë ajo, pa dyshim, është e pasur si në rite ashtu edhe në tekste e melodi, të cilat nga njera anë u kushtohen ngjarjeve të quajtura rituale, nga ana tjetër i kushtohen dashurisë. Në këtë rast këto këngë përbëjnë si të thuash preluadin e procesit të ardhshëm të martesës, pra të dasmës.

Duke pasur parasysh këtë edhe ne

pikërisht këtë vëllim e botojmë pas vëllimit «Këngë dashurie». Në këtë mënyrë, të dyja këto vëllime, bëjnë një tërësi, me anën e së cilës do të duket më së miri pasuria e madhe e shprehjes, në mënyrë artistike, e ndjenjave të larta popullore për këto dy fenomene jetësore.

Zakonet shqipëtare, si për fejesën ashtu edhe për martesën, janë të ndryshme, të cilat përfaqësojnë qëndrimin e formacioneve të ndryshme shoqërore që ka kaluar edhe populli ynë. Prandaj nëpër to, nga një anë gjejmë elemente pagane, elemente patriarkale, feudale dhe borgjeze, nga një anë tjetër gjejmë vrejthe të realiste që përfaqësojnë mendimin popullor. Kështu disa prej tyre sot janë vetëm mbeturina që u shërbejnë studi-meve, disa përfaqësojnë kushte të caktuara historike, disa humbasin, si pranike, përpara moralit socialist, i cili e ka vendosur edhe femerën në kushte të barabarta me burrin.

Në tërësinë e tyre, ritet, tekstet dhe meloditë e dasmës - edhe sepse kushtet historiko-ekonomike, struktura etnografike e popullit tonë në të kaluarën, kanë pasur ndryshime krahinore - shprehin ekzistencën e një bashkësie të padiskutueshme të popullit Shqiptar. «Brumi», që është një rit mjaft interesant, megjithëse në trajta të ndryshme, e ndeshim kudo në Shqipëri. Në Gjirokastrë «Brumi» është një ceremoni e tërë; në Myzeqe e këndojnë këngën e brumit dhe «kulacin e nuses» e gjuajnë me shigjetë; në Shkodër, kur nusja hyn në shtëpi, i vënë një simite nën sqetull etj. «Brumi» nuk është një rit që u përket vetëm myslimanëve, ay u përket edhe kristjanëve,

mbasi edhe këta, gjatë kurorës, i thyejnë nuses një kulaç në kokë. Pra riti i tij është parakristjan dhe paramysliman. Kështu edhe «hedhja e orizit». Mjaftojmë me këto dy rituale - se nuk është vëndi këtu për t'u zgjeruar, - që të menjohet për bashkësinë e popullit tonë, si një dhe i pa ndarë. Edhe «dita e nuses», që në përgjithësi bëhet ditën e diel, pa dallim fetar, e dëfton qartë këtë bashkësi. Këtë bashkësi e tregojnë fare mirë edhe tekstet e këtyre 250 melodive.

«Fejesa» ose «vlesa» bëhet pas dhënies së fjalës, ose pas «prerjes së fjalës», që në të kaluarën bëhej prej «krushqarit», i cili në disa vënde quhet «shkes», «kapucar», e në disa raste «këpucëgrisur», etj. mbasi në këtë rast, atij do t'i jepeshin një palë këpucë peshqesh. Prerja e fjalës, në Shqipërinë e mesme, quhet edhe «kafet e vogla». Pas kafeve të vogla, ta themi kështu, bëhet fejesa ose «nishani», që nuk është vetëm një vepërim ceremonial, po edhe një akt zyrtar i lidhjes së krushqisë.

Dasma zhvillohet në një proces njëjavor. Rrjeshtimi i riteve, të cilave u përgjigjen edhe tekstet e melodit e tyre, është, si të thuash, një veprim i kodifikuar. Në tërësinë e tyre ritet e dasmës, janë si një pjesë teatrale me aktet dhe skenat e veta, që nuk mund të kapërcëjnë njera tjetrën. Pasi pritet koha e martesës, dmth «dita e nuses», dita kur krushqit do të vinë për të marrë nusen, kryhen gjatë javës; prerja e druve, të qëruarit e grurit, përgatitja e qigrave për të zënë bukët, nata e brumit, kënaja, të rruarit e dhëndërit, dita e nuses. Pasuria e riteve ka pasuruar njëkohësisht si tekstet ashtu edhe meloditë.

Si shihet nga titulli i këtij vëllimi, duke marrë parasysh se tekstet dhe melodit e tyre janë zgjedhur midis shumë të tjerave, pasuria e tyre për dasmën është tepër e madhe. Ato edhe sepse janë të afërta, motërzime, nuk janë kufizuar, përkundrazi janë zbukuruar e shumuar tepër me larminë e tyre, e cila nuk ka ngjarë për shkak të motërzimeve, por edhe për shkak të larmisë së melodive tona popullore homofonike dhe polifonike.

Melodika e këngëve të dasmës në kushtet e ndjenjave të shprehura, për atë

ose këtë ngjarje, javën e dasmës, kanë përfutuar jone dhe gjuhë muzikore të veçanta, duke pasuruar kështu lulëzimet e veta, në tërësi të gëzueshme, por herë-herë elegjiake, satirike e herë-herë sarkastike, me anën e të cilave, populli në mënyrë realiste ka pasqyruar gjendjen e vërtetë të nuses, në gjirin e familjes patriarkale e feudoborgjeze.

Në këtë vëllim tekstet dhe meloditë janë zgjedhur, pothuaj, nga të gjitha viset e Shqipërisë. Në këtë mënyrë jo vetëm lexuesi i thjeshtë do të mund të shtojë njohurit e tij me anën e teksteve, po edhe kompozitorët e studjonjësit të mund të marrin kontakt me bukuritë muzikore të melodive. Nga ana tjetër edhe studjonjësit ky vëllim besojmë se do t'u shërbejë veçanërisht për studime të veçanta etiko-morale dhe muzikore, të teksteve dhe melodive të një lloji në gjininë e lirikës sonë popullore.

Vëllimi, na u duk më drejt, të ndërtohej mbi dy vijat kryesore të melodive tona: homofonike dhe polifonike, duke i grupuar këto në burimet e tyre krahnore. Në këtë mënyrë përdorimi i vëllimit është më i përshtatshëm, për të vështruar përhapjen e ngjarjeve, mënyrën e trajtimit të ngjarjeve dhe të melodive.

Megjithkëtë vëllimi nuk është i plotë; se vetvetiu, numuri është pak a shumë i kufizuar, mbasi kemi shfrytëzuar pasurinë aktuale të arkivit të Institutit. Pa dyshim, kërkimet e mëtejshme do ta pasurojnë më shumë arkivin; ahëre do të rriten mundësitë për të dhënë një vëllim shumë më të madh tekstesh dhe melodish, për të bërë një rrjeshtim më të plotë krahnor, e kombëtar.

Meloditë e përmbledhura në këtë vëllim janë një kontribut tepër i vlefshëm i vjelur nga grupet dhe këngëtarët më të mirë, të cilët duke shfrytëzuar brendinë e teksteve, që flasin për ngjarjet, ata i kanë ekzekutuar këto me art të lartë dhe zemër të ngrohët. Për to ata nuk janë thjesht bartës automatë, po janë njëkohësisht rikrijonjës, krijonjës dhe pasuronjës shumë të talentuar. Duke i ekzekutuar këngët ata e kanë ndërplotësish të vehten midis dasmës, në të gjitha ngjarjet e saj, si pjesëtarë aktivë, për ta paraqitur atë me realizëm sa më të lartë, si solistë

edhe si grupe burrash apo grash, që paraqiten në këtë vëllim me ato ose këto këngë. Për këtë vëllim, redaktorët janë përpjekur të zgjedhin nga të gjitha llojet e melodive, veçanërisht të atyre polifonike: me dy, me tre dhe katër zëra. Ky vëllim është një provë tjetër e përpjekjeve të redaktorëve të tij për të plotësuar tekstet dhe meloditë me të dhënat më të domosdoshme, ndryshimet melodike, që ndeshen në to: në lulzimet, në dizonancat e të tjera elemente, që meloditë të mund të paraqiten sa më të plota. Redaktorët janë përpjekur gjithashtu të kapërcojnë edhe mjaft vështirësi që paraqesin, sidomos, këngët polifonike me më shumë se dy zëra, të cilat, siç dihet, kanë një zhvillim jashtëzakonisht të madh të vijës së tyre melodike.

Megjithkëtë duhet thënë se vëllimi ka pa tjetër edhe të meta. Botimet tona në fushën e këngëve dhe melodive popullore janë me pak tradita. Prandaj, për ne do të ishte shumë e dobishme ndihma e shokëve muzikologë e kompozitorë, e shokëve pedagogë të Konservatorit, që me vërejtjet dhe kritikën e tyre, të mund t'u përgjigjemi akoma më mirë kërkesave si praktike ashtu edhe shkencore, sepse për botimet e Institutit tonë, ne udhëhiqemi nga mendimi që tekstet dhe meloditë tona popullore të mos ngushtohen vetëm për një përdorim thjesht shkencor, po të mund të ndihmojnë edhe grupet e shtëpive të kul-

turës, solistët, grupet e estradave, mësuesit e muzikës, veçanërisht studentët e Konservatorit, e nxënësit e Liceut Artistik për t'i njohur si tekstet ashtu edhe meloditë tona popullore, për t'i përhapur ato, në mënyrë që të jetojnë e të pasurohen, dita ditës, në kushtet e kulturës sonë socialiste, në kushtet aktuale për zhvillimin e muzikës sonë kombëtare të të gjitha gjinive.

Në fund të vëllimit janë shënuar të dhënat e plota për këngëtorët, grupet, për funksionet e këngëtorëve brënda për brënda grupit, të dhënat arkivale të dokumentacionit të inçizimeve, të shënimeve të veçanta të transkriptimit muzikor, vëndburimi i teksteve dhe melodive si edhe një fjalor, për fjalët që na u dukën të domosdoshme për t'i shpjeguar. Gjithashtu, po në fund të vëllimit, jepet edhe një indeks i posaçëm referencash për grupimin e teksteve dhe melodive, për të lehtësuar studjonjësit e teksteve dhe melodive edhe rreth një ngjarjeje të veçantë të dasmës.

Me këtë rast, e quajmë për detyrë të falënderojmë këngëtorët e grupet, që me këngët e tyre pasurojnë çdo ditë arkivin tonë, si edhe kompozitorin shokun Baki Kongoli, i cili me recensimin që i bëri këtij vëllimi, na dha një ndihmë të vlefshme me vërejtjet dhe sugjerimet e tij.

ZIHNI SAKO

1. PËR TË MIRËN SHITE ATIN

ALLEGRETTO (♩ = 140)

Për të mi- rën- o shi- te a- tin, e për të
mi- rën- o shi- te a- tin, nus- ja e ke- se, ta fik ko-
na- kin, nus- ja e ke- se. ta fik ko- na- kin.

Për të mirën shite atin,
Nusja e keçe, ta fik konakin,
Për të mirën shite dorin,
Nusja e keçe, ta fik shpin;

Për të mirën shit' ni cop tok,
Se t'ka hije me dal ner shok;
Ç'e do mallin, ç'e do xhan,
Merr të mejrën e kalo dinjan!

2. SONTE ASHT E EJTE MRAMA

ALLEGRETTO (♩ = 140)

ho e ej- te mra- ma, Son- te asht o e
ej- te mra- ma, vish je- le- kun- o, he, lum na- na.
vish je- le- kun- o, he, lum na- na!

Sonte asht e ejte mrama,
— Vish jelekin, he, lum nana!
— Nuk e due, jelekin, nuk e due,
Se po kan nana për muel

Sonte asht e ejte mrama,
— Vish mitanin, he, lum nana!
— Nuk e due, mitanin, nuk e due,
Se po kan baba për muel

3. KUR MA VUNE KANËN

ALLEGRETTO (♩ = 8H)

Kur ma vu-ne ka-nën, kur ma vu-ne ka-nën, e ke dit se
 rri pa na-nën, dil, za-ne, e ke dit se rri pa na-nën?
 Dil, za-ne?

Kur ma vune kanën,
 E ke dijt se rrin pa nanën?
 Dil, zane!
 Kur dole në der,
 A dul baba me t'përcjell?

Dil, zane!
 Kur dole në shkall,
 A t'tha vilaj — udh' e mar?!
 Dil, zane!

4. MOS PRE DHEN E DHI

ALLEGRETTO (♩ = 120)

Mos pre dhen e dhi, o-re lum ja da da.
 se do t'fi-kesh ti, o-re, lum-ja da da.
 se do t'fi-kesh ti, o-re lum-ja da da

Mos pre dhen e dhi,
 Ore, lumja dada! (Refren)
 Se do fikesh ti,
 Dhen e dhi t'i presësh,
 Xhall ku do jesësh?

5. NË PAÇ BA NUSEN E KEÇE

ANDANTINO (♩ = 80)

Në paç ba nu- sen e ke- çe, shku-es-o e shku-es-e,
shku-es-o e shku-es-e.

Në paç ba nusen e keçe,
Shkueso e shkuese! (Refren)
T'u baft udha mexhe, mexhe;
Në paç ba nusen e mëjr,
T'u musht udha dranafëjll;

Në paç ba nusen e but,
T'u musht udha gjërnabut;
Në paç ba nusen e egjër,
T'u baft udha tëj me megjëll!

6. KUR T'I ÇOJM PARE

ALLEGRETTO. (♩ = 146)

O kur t'i çojm pa- re, oh, o nu- ses As. Ila- nit, kur
t'i çojm pa- re, ni va- li- xhe me pet- ka ar- e,
ni va- li- xhe me pet- ka ar- e!

Kur t'i çojm pare,
Oh, nuse e Dh. N.,
Kur t'i çojm pare,
Ni valixhe me petka are!
Kur t'i çojmë lira,
Oh, nuse e Dh. N.,
Kur t'i çojmë lira,
Ni valixhe me petka t'mëjra!

11. U KPÛT RRUSHI PREJ HARDHIS

ANDANTE [♩ = 76]



U kput rrushi prej hardhis,
U nda lulja prej shtëpis!
Shuj moj lule, shuj mos koj,
Se na bone ton me voj!
N'kri t'di jave shkon opet,
Bun di net e ven opet.

U kput rrushi prej hardhis,
U nda lulja prej shoqnis!
Shuj moj lule, shuj mos koj,
Se na bone ton me voj!
N'kri t'di jave shkon opet,
Bun di net e ven opet.

12. LINE ÇARDAKIN ME MJALT

ALLEGRETTO [♩ = 160]



Line çardakin me mjalt,
Oh, moj lule! (Refren)
Kah të ecish mos rropat,

Se na kemi hismet shum,
Tan shtëpejs t'i rrojsh n'kam.

13. NAN' E NUSES E PA FE

ALLEGRETTO [♩ = 150]



Nan' e nuses o e pafe,
Na ka than: — kam cucën e re,
E re vet, e re sivet,

Do ta rrëjte sa ni plep,
Sa ni plep e sa ni pregjell,
Do t'na vëje nusja me rregjell! --